



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023

Nr. 527

Ora: 14.00

VENDIM

PËR

**PAJISJEN E QENDRËS SË POSAÇME TË VOTIMIT NR. 4451/00, KZAZ NR. 85, BASHKIA VLORË,  
ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 85, Bashkia Vlorë, njofton se në Qendrën e posaçme të Votimit nr. 4451/00, të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, nevojiten 40 fletë votimit shtesë, dhe i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pajisjen e kësaj I.E.V.P-je, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur, të cilët kanë të drejtë vote, por nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve, të kësaj qendre votimi të posaçme.

Shtetasit të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion kanë fituar të drejtën për të votuar në Qendrën e Votimit nr. 4451/00, KZAZ nr. 85, Bashkia Vlorë, sipas vendimit të gjykatës.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimi për të mundësuar votimin e shtetasve të sipërcituar.

Data: 14.5.2023 Nr: 527  
Ora: 14:00



“Për pajisjen e qendrës së posaçme të votimit nr. 4451/00, KZAZ nr. 85, Bashkia Vlorë, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 85, Bashkia Vlorë, që të pajisë me sasinë shtesë të fletëve të votimit, qendrën e posaçme të votimit nr. 4451/00.
2. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merren nga qendrat e votimit nr. 4446/00 dhe nr. 4446/01, të KZAZ nr. 85, respektivisht, nga 20 (njëzetë) fletë votimi për kandidatët për kryetar bashkie dhe 20 (njëzetë) fletë votimi për Këshillin e Bashkisë, nga secila qendër votimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**